



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË PËR PUNË

**KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;**  
*dhe*

**"CONSRUCTION GROUP" Shpk nga Prishtina, të cilën e përfaqëson, z. Arjeta Aliti, me Nr. Rexh. Biznesi, 810831645 (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:**

### **TITULLI I KONTRATËS:**

**RREGULLIMI I VORREZAVE NË LAGJEN KAMENICË – FSHATI SUDENICË – LOT 2**

<b>Nr. Prokurimit</b>	<b>633-20/4975/ 536/ C384 – lot 2</b>
<b>Nr. I brendshëm</b>	<b>633 / 20 / 074 / 536</b>

### **Neni 1 Lënda**

**1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:**

**RREGULLIMI I VORREZAVE NË LAGJEN KAMENICË – FSHATI SUDENICË – LOT 2**

### **Neni 2 Çmimi**

**2.1 Vlera e PLANIFIKUAR kontratës për punimet ASFALTIMI I RRUGËS NË LAGJËN "ZOGAJ" KALIQAN LOT-1 është: 2.218,00 € dhe me fjalë: /Dymijëdyçindetëmbëdhjetëzerozeroeuro/ €**

2.3. Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.4. Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

*Marrëveshja e kontratës;  
Kushtet e Veçanta të Kontratës;  
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;  
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;  
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralloqaria);  
Plani për menaxhimin e kontratës*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### **Neni 4 Afati i përmbushjes së kontratës:**

4.1 Kontrata do të përmbushet ne afat prej 30 ditësh, nga data e nënshkrimit të se njëjtës, perkatesisht me se larti deri me: 30. 11. 2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk përmbushet ne afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të pergjigjet per demet eventuale te shkaktuara Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve te përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

### **Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të

gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.





5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues:**

**Komuna e Istogut**

**Për kontraktorin:**

**"CONSTRUCTION GROUP" Shpk**

<b>Emri:</b>	Gëzim Ademaj	<b>Emri:</b>	ARJETA ALITI
<b>Pozita:</b>	U.D. Menaxherit të Prokurimit	<b>Pozita:</b>	D r e j t o r ,
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data</b>	22.10.2020	<b>Data</b>	22.10.2020
<b>V u l a:</b>		<b>V u l a</b>	

## PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Objekti: RIKONSTRUIMI I VARREZAVE NË FSHATIN KAMENIC-ISTOG

Lokacioni: Kamenic

Komuna: ISTOG

### 1. PUNËT NDËRTIMORE

1	PUNËT E DHEUT				
	PËRSHKRIMI	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI/NJËSI	TOTAL
1	Hapja e punishtes. Sjellja e materialeve, makinerise dhe mjeteve te punes per kryerjen e punimeve te parapara me kontrate. Furnizimi me material, punimi dhe vendosja e tabelës lajmeruese. Verejtje: Tabela lajmeruese punohen nga korniza metalike ne te cilen vendoset pllaka nga llamarina dhe folia nga pvc ku te jete e shkruar : Emri i kontrates, numri i prokurimit, emri i investitorit, punekryesit, plani dinamik i parapare per kryerjen e punimeve, vlera e kontrates.	copë	1	50.00	50.00
2	Rrethimi i truallit për ndërtimin e objektit me konstrukcion metalik dhe llamarinë të zinkuar me lartësi 2m në tërë perimetrin e caktuar të punishtës.	m'	260.00	0.10	26.00
3	Furnizimi me material dhe ndërtimi i rrjetit të përkohëshëm të ujësjellësit, kanalizimit, rrjetit elektrik dhe ndriqimit të kantierit, vendosja e kontejnerit për zyren e menagjimit të projektit	copë	1	20.00	20.00
4	Pastrimi i oborrit nga shkurret, barnishtet dhe vegjetacioni tjetër, transporti i mbeturinave deri ne deponi.	m <sup>2</sup>	3000.00	0.20	600.00
5	Punimi me bager, per largimin e te gjitha mbeturinave qe gjinden ne objekt. transporti i mbeturinave deri ne deponi.	ore	8.00	40.00	320.00
6	Pas përfundimit të punimeve të gjitha ndërtimet e përkohshme duhet të largohen dhe të bëhet pastrimi i objektit si dhe lereni rreth objektit.	copë	1	50.00	50.00
7	Te behet germimi i dheut, dhe te largohet jashe varrezave. Verejtje. Punimet duhet te behen me kujdes (kryesisht me punedore) ne menyre qe te mos demtohen muret e varrezave dhe muret dekorative te lapidarit.	m <sup>3</sup>	460.00	1.20	552.00
8	Mihja, lavrimi, perpunimi i dheut ne pjeset e parapara te mbillet bar. Furnizimi me farë dhe mbjellja e barit, dhe pergadilja per mbjellje te trendafilave dhe luleve te modeleve te tjera	m <sup>2</sup>	3000.00	0.20	600.00
				TOTALI	2,218.00

### RIKAPITULIM

1. PUNËT NDËRTIMORE	2,218.00 €
Gjithësejt punët në Dheut	2,218.00 €

